



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Shk.II.nr.361/2022

GJYKATA KOMERCIALE – DHOMA E SHKALLËS SË DYTË, e përbërë nga gjyqtari individual Franciska Zhitija-Ymeri, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës”, me seli në Prishtinë, ndaj debitorit “S....” me seli në Prishtinë lagjja “....” A-3,, me përfaqësues sipas autorizimit Kerveshi & Partners Sh.p.k nga Prishtina, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, E.nr.158/14 dt.28.12.2020, me datën 21.11.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit “S....” me seli në Prishtinë lagjja “....” A-3,, **VËRTETOHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, E.nr.158/14 dt.28.12.2020.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar E.nr.158/14 dt.28.12.2020, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit “S....” me seli në Prishtinë lagjja “....” A-3,, i parashtruar ndaj aktvendimit për lejimin e përmbartimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë E.nr.158/14 te datës 30.04.2020.

Kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor, ankesë ka parashtruar debitori përmes përfaqësuesit të tij sipas autorizimit Kerveshi & Partners Sh.p.k nga Prishtina, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës përmbartimore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe të lejohet urdhri i propozuar ose lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori “Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës”, me seli në Prishtinë, me datën 22.01.2014, ka paraqitur propozim për përmbarrim, ndaj debitorit “S....” me seli në Prishtinë lagja “....” A-3,, në bazë të Vendimit Nr.697/2013 të datës 06.12.2013, lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale –Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës, në vlerën prej 2,500 euro.

Gjykata Themelore në Prishtinë, duke vendosur lidhur me propozimin për përmbarrim të kreditorit ka nxjerrë aktvendimin E.nr.158/14 të datës 30.04.2020 me të cilin e ka lejuar përmbarrimin.

Ndaj këtij aktvendimi debitori me datën 06.07.2020, ka ushtruar prapësim, me arsyetimin se debitori asnjëherë nuk e ka pranuar vendimin e TEIP prandaj nuk mund të përmbarrohet një vendim i tillë ndaj debitorit, sepse sikur ta pranonte debitori këtë vendim i njëjti do të ushtronte ankesë dhe mjetet tjera juridike të parapara me ligj. Vendimi mbi të cilin është lejuar përmbarrimi nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë pasi asnjëherë nuk është pranuar nga debitori, ndërsa shton se gjykata ka caktuar përmbarrimin por nuk ka sjellë dëshmi se debitori e ka pranuar vendimin e TEIP, propozon që ta pranoj si të bazuar prapësimin, ta anuloj aktvendimin e gjykatës E.nr.158/14 dt.30.04.2020 dhe ta obligoj kreditorin që ti paguaj shpenzimet e procedurës përmbarrimore.

Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm, pas analizimit të shkresave në lëndë dhe prapësimit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar E.nr.158/14 të datës 28.12.2020, me të cilin e ka refuzuar prapësimin e debitorit si të pabazuar, duke vendosur si në dispozitiv të njëjtit. Në arsyetim të aktvendimit gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se debitori i përmbarrimit nuk ka ofruar prova në mbështetje e pretendimeve të tij siç është paraparë me nenin 69 par.4 të LPP, rrjedhimisht nuk janë plotësuar asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e aktvendimit mbi caktimin e përmbarrimit apo shtyrje të zbatimit të përmbarrimi. Gjykata nuk ka tagër të lëshohet në shqyrtimin e ligjshmërisë së titullit ekzekutiv, andaj edhe vendosi si në dispozitiv.

Dhoma e Shkalles së Dytë e Gjykatës Komerciale nisur nga kjo gjendje vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm pasi aktvendimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë për çka edhe Dhoma e Shkalles së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së dytë ka konstatuar drejtë faktin se vendimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Inspektoratit të Punës në Prishtinë, me nr.697/2013 të datës 06.12.2013 në rastin konkret është dokument përmbarrues, kjo parashihet në nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të

LPP-së, e cila dispozitë përcakton se “Dokument përbarues është edhe vendimi përbarues i dhënë në procedurë administrative” dhe përbën bazën juridike për caktimin e përbarimit sipas nenit 21 duke i plotësuar kushtet nga neni 24 paragrafi 3 dhe neni 27 paragrafi 1 të po të këtij ligji ku përcakton se “ Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftëse në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.”

Pretendimet e debitorit se vendimi nr.697/2013 te datës 06.12.2013 i Inspektoratit të Punës në Prishtinë nuk i ka tiparet e përbarushmërisë nuk qëndron, ngase fakti se vendimi në fjalë nuk e ka klauzulë të plotfuqishmërisë dhe përbarushmërisë, nuk qon peshë, kjo për shkak se bëhet fjalë për vendim të marrë në procedurë administrative, e që me nenin 24.5 të LPP-së është paraparë se “ *përbarimi caktohet në bazë të vendimit gjyqësor që ende nuk është bërë i formës së prerë, ose në bazë të vendimit të dhënë në procedurën administrative që nuk është bërë përfundimtare , vetëm po që se me ligj është paraparë se ankesa apo mjetet tjera juridike, nuk e ndalon përbarimin*”, ndërsa nga ana tjetër me nenin 6.4 të Ligjit për Inspektoratin e Punës është paraparë se “*ankesa e ushtruar në vendimin e Inspektoratit të punës nuk e shtyn ekzekutimin*” e cila klauzulë figuron në dispozitiv të vendimit të inspektoratit të Punës, përbarimi i të cilit është lejuar nga përbaruesi privat, prandaj në këtë rast nuk ka rëndësi fakti se këtij vendimi i mungon vula e plotëfuqishmërisë dhe e përbarushmërisë.

Përndryshe, në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin. Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përbarimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes se përbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente, ngase një pretendim i tillë i tij, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përbarimit në këtë rast.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale –Dhoma e Shkalles së Dytë në Prishtinë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispoziten e nenit 3 par.2 te LPP me të cilën është paraparë se në shkallen e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga sa u tha me lartë në kuptim të nenit 209, par.1, pika b), të LPK-së e lidhur me nenin 17 të LPP u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-DHOMA E SHKALLES SE DYTË
K.DH.SH.II nr.361/22, me datë 21.11.2022

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija-Ymeri